

VENDIM
Nr. 31, datë 21.1.2026

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2026, TË ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA (ERRU)

(Ndryshuar me vendimin nr. 489, datë 26.6.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. *Miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2026, të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, në shumën 83 713 216 (tetëdhjetë e tre milionë e shtatëqind e trembëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.*

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ENTI RREGULLATOR I UJIT (ERRU)

Pasqyra nr. 1

PLANI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2026
(Ndryshuar me vendimin nr. 489, datë 26.6.2026)

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	Viti 2026 (lekë)
1.	Pagat dhe shtesat e tjera	55,827,345
2.	Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	8,940,525
3.	Shërbime e furniturë	17,202,960
4.	Investime	1,742,386
	TOTALI	83,713,216